



Republika e Kosovës/Republika Kosova/Republic of Kosovo
Qeveria/Vlada/Government
Ministria e Punëve të Jashtme/Ministarstvo Inostranih Poslova/Ministry of Foreign Affairs
Akademia Diplomatike/Diplomatska Akademija/Diplomatic Academy

Qendra për Mësimin e Gjuhës në Prishtinë

Memorandum i Bashkëpunimit

në mes të

**Akademisë Diplomatike në Ministrinë e Punëve të Jashtme
Republika e Kosovës**

dhe

**Qendrës për Mësimin e Gjuhës në Prishtinë
Partner i Institutit Goethe**

Akademia Diplomatike në Ministrinë e Punëve të Jashtme, Republika e Kosovës dhe Qendra për Mësimin e Gjuhës në Prishtinë, Partner i Institutit Goethe, pajtohen si në vijim:

Neni 1
Shërbimet të cilat do të ofrohen

Qendra për Mësimin e Gjuhës në Prishtinë, në hapësirat e veta, do të ofrojë kurse të mësimit të gjuhës gjermane për 24 zyrtarë (12 zyrtarë në secilin nivel), për nivele dhe periudhë kohore si në vijim:

- a. Kurs për nivelin A 1.1. (60 orë mësimore 45 minutëshe, 2 herë në javë nga 2 orë mësimore) nga 19.10.2015 për 15 javë, dhe
- b. Kurs për nivelin A 2.1. (60 orë mësimore 45 minutëshe, 2 herë në javë nga 2 orë mësimore) nga 19.10.2015 për 15 javë.

Neni 2
Shpenzimet

Akademia Diplomatike në Ministrinë e Punëve të Jashtme, Republika e Kosovës dhe Qendra për Mësimin e Gjuhës në Prishtinë përmes këtij Memorandumi të Bashkëpunimit janë pajtuar që tarifa për këto shërbime të ofrohet me zbritje prej 50%, dhe se tarifa e tillë pas zbritjes për secilin nivel të jetë nga 1,129.68 €. Ky çmim përfshinë gjithashtu edhe librat e destinuar për secilin nivel (librin e kursit dhe librin e punës).

Neni 3
Provimi Start Deutsch 1 të Institutit Goethe

Akademia Diplomatike në Ministrinë e Punëve të Jashtme, Republika e Kosovës dhe Qendra për Mësimin e Gjuhës në Prishtinë përmes këtij Memorandumi të Bashkëpunimit janë pajtuar që pas pjesëmarrjes së suksesshme në Kursin A 1.2., vijuesit e kurseve mund të marrin pjesë në provimin e njohur ndërkombëtarisht Start Deutsch 1 të Institutit Goethe, me ç'rast do të paguajnë 50% të tarifës zyrtare për provim, të vendosur nga organizuesi i provimeve.

Nënshkruar më **19 tetor 2015** në **Prishtinë**, në dy kopje origjinale, që të dyja në gjuhën shqipe.

Për:
Akademinë Diplomatike në Ministrinë
e Punëve të Jashtme, Republika e Kosovës

Për:
Qendrën për Mësimin e Gjuhës në Prishtinë
Partner i Institutit Goethe



Z. Skender Durmishi
Drejtor



Znj. Annamaria Farkas-Mecinaj
Drejtoreshë